

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 310, Datë 12.12.2025

MBI

**MIRATIMIN E KËRKESËS SË ALBGAS SH.A. PËR SHTYRJEN E PROCEDURËS SË
MIRATIMIT TË PLANIT DHJETËVJEÇAR TË ZHVILLIMIT TË RRJETIT**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; pikës 12 të nenit 16, neneve 46 dhe 56, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; pikës 3 të nenit 53, të ligjit nr. 44/2015 “Kodit i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 3011 prot., datë 12.12.2025 të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, për “Shtyrjen e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve nga shoqëria Albgaz Sh.a.”

Konstatoi se:

- Shoqëria Albgaz sh.a. ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Energjisë kërkesën për miratimin e Planit Dhjetëvjeçar të Investimeve (2023–2032), për të cilën bordi i ERE-s, me vendimin nr. 293, datë 12.10.2023, ka vendosur fillimin e procedurës së shqyrtimit.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 277, datë, 13.12.2024 vendosi “Shtyrjen e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve nga shoqëria Albgaz sh.a” me afat deri në dhjetor 2025.
- Me shkresën nr. 2852 prot., datë 13.11.2025, ERE i është drejtuar shoqërisë Albgaz sh.a. me lëndë “Kërkesë për dorëzimin e dokumentacionit plotësues për vijimin e procedurës së miratimit të Planit Dhjetëvjeçar të Investimeve (2023–2032)”.
- Në përgjigje, shoqëria Albgaz sh.a., në cilësinë e Operatorit të Kombinuar të Gazit Natyror, me shkresën nr. 119/1 prot., datë 27.11.2025, protokolluar me nr. 2852/1 prot., ka kërkuar shtyrjen e procedurës së miratimit të Planit Dhjetëvjeçar të Zhvillimit të Rrjetit deri në dhjetor 2026, duke informuar për problematika dhe procese ende në zhvillim lidhur me përmbushjen e kërkesave rregullatore të ERE-s.

- Albgaz sh.a. është informuar nga KESH sh.a., me shkresën nr. 3933/2 prot., datë 28.08.2023, për një defekt në sistemin e ftohjes së asetit termik TEC Vlorë, i cili ndodhet jashtë gatishmërie dhe në konservim.
- KESH sh.a., në cilësinë e shoqërisë kontrolluese, ka ndërmarrë procesin e vlerësimit teknik dhe planifikimit të ndërhyrjeve të nevojshme për rivënien në punë të asetit, në funksion të mundësisë së gjenerimit të energjisë përmes gazit natyror.
- Gjithashtu Albgaz sh.a.: i) ka vënë në dijeni Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë lidhur me planifikimin e shpenzimeve dhe fondeve për projektet e shoqërisë (shkresa, nr. 106 prot., datë, 18.09.2023); ii) i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë si organi më i lartë vendimmarrës, me kërkesën për t'iu drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me një kërkesë zyrtare për dhënie opinionit në lidhje me Planin 10-vjeçar të Investimeve që shoqëria Albgaz sh.a. (shkresa nr. 132 prot. datë, 02.11.2023).
- Më datë 12 dhjetor 2024, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Albgaz sh.a. dhe SOCAR nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi për zhvillimin e projektit të gazifikimit të qytetit të Korçës, si pjesë e zgjerimit të rrjetit kombëtar të gazit natyror.
- Në vijim të këtij angazhimi, Albgaz sh.a., në zbatim të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi, ka marrë pjesë në Market Test-in e TAP AG për vitin 2025 për sigurimin e një pike dalje në tubacionin TAP për Korçën dhe, pas pagesës së tarifës përkatëse dhe nënshkrimit të Commitment Letter, është në pritje të përcaktimit të hapave të mëtejshëm të projektit.
- Duke qënëse aktualisht Albgaz sh.a. është në një fazë të rëndësishme të zhvillimit të sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror ku Ministria e Infrastruktures dhe Energjisë luan një rol shumë të rëndësishëm të këtij zhvillimi, jo vetëm si institucion përgjegjës për politikën e zhvillimit të sektorit të gazit natyror, por edhe të mbikëqyrjes së ecurisë së projekteve të zhvillimit dhe të ndërtimit të sistemit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, Albgaz sh.a. bën me dije se do të përditësojë planin e saj dhjetëvjeçar të investimit duke reflektuar edhe zhvillimin e projektit NUR për gazifikimin e qytetit të Korçës, si një prioritet strategjik e parashikuar si i tillë edhe me VKM-në nr. 563, datë, 04.10.2023.
- Nëpërmjet shkresës me nr. 2852/1 prot., datë, 27.11.2025 të cituar më sipër kërkon shtyrjen e afatit të dorëzimit të planit dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit deri në muajin Dhjetor 2026.
- Në pikën 3 të nenit 53, të ligjit nr. 44/2015 “Kodit i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: *“Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”*
- Për gjithë sa më sipër, duke qenë se marrja e vendimeve/qëndrimeve të organeve kompetente si më sipër, është parakusht për marrjen e një vendimi përfundimtar nga ERE, vlerësohet që të

merret parasysh kërkesa për shtyrjen e afatit të vendimmarrjes së bordit mbi kërkesën e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. për miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve deri në dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar dhe përgatitjen e një informacioni të plotë e të saktë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Albgaz” sh.a. për shtyrjen e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve deri në muajin dhjetor të vitit 2026.
2. Drejtoria e Gazit Natyror, të njoftojë shoqërinë “Albgaz”sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI